



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:263352

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05480303

CP.nr.154A/14

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri dhe bashkëpunëtorin profesional Besart Prishtina, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë në rr. “Armend Daci” nr.1, kundër debitorit M.J nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. N.A, me seli të zyrës në Vushtri, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtri, CP.nr.154A/14 të datës 28.08.2015, jashtë seance me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit M.J, i ushtruar kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtri, CP.nr.154A/14 të datës 28.08.2015.

A r s y e t i m

Kreditori Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë në rruga “Armend Daci” nr.1, në bazë të aktvendimit Nr.3655 të datës 03.09.2013, i formës së prerë nga data 10.10.2013 dhe i ekzekutueshëm nga data 26.10.2013, ka parashtruar propozim për përmbartim pranë Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtri, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet

debitori M.J nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, që në emër borxhit ta paguaj shumën prej 23,552.60 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega Vushtrri, me aktvendimin CP.nr.154A/14 të datës 28.05.2015 e ka lejuar përmbarrimin sipas propozimit të kreditorit.

I autorizuari i debitorit brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim kundër aktvendimit për lejimin e përmbarrimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë –Dega Vushtrri me pretendimet se i propozimi për përmbarrim është i pabazuar dhe se nuk ka titull ekzekutiv. Tutje ka shtuar se propozimi për përmbarrim është paraqitur me datën 26.02.2014, ndërsa aktvendimi është i datës 20.11.2013, ashtu që sipas nenit 121 të Ligjit për Procedurën Administrative afati kohor për ekzekutimin e aktit nga administrata është 15 ditë, ndërsa kreditori propozimin përmbarrim e ka paraqitur 80 ditë me vonesë, duke i propozuar gjykatës që prapësimin ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe ta anuloj urdhrin përmbarrimor të përmbarruesit privat.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim duke theksuar se aktvendimi në bazë të të cilit është paraqitur propozimi për përmbarrim është në harmoni të plot me kërkesat e Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, përmban të gjitha elementet e kërkuara duke shtuar se nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e prapësimin ashtu që, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit t'a refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarrimor, përkatësisht Vendimin Nr.3655 të datës 03.09.2013, në bazë të së cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarrues sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata gjeti se

Vendimi Nr.3655 të datës 03.09.2013, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi Nr.3655 të datës 03.09.2013, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi Nr.3655 të datës 03.09.2013, i nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, është bërë i formës së prerë me datë 10.10.2013 dhe i ekzekutueshëm nga data 26.10.2013.

Nuk është pranuar pretendimi i debitorit se propozimi për përmbarim është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar, për faktin se sipas vlerësimit të kësaj gjykate me dispozitën e nenit 361 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”*. Në kuptim të kësaj dispozite gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me humbje të afatit për paraqitjen e propozimit për përmbarim, pasi që në këtë çështje juridike përmbarimore, përmbarimi është lejuar në bazë të aktvendimit Nr.3655 të datës 03.09.2013, i formës së prerë nga data 10.10.2013 dhe i ekzekutueshëm nga data 26.10.2013, ndërsa propozimin për përmbarim kreditori e ka parashtruar me datë 26.02.2014, çka do të thotë se nga dita e plotfuqishmërisë së dokumentit përmbarues 10.10.2013, e deri në ditën e paraqitjes së propozimit për përmbarim me datë 26.02.2014, nuk kanë kaluar 10 vite, andaj edhe na rezulton se kreditori me kohë ka paraqitur propozimin për përmbarim, me çka një pretendim i tillë u refuzua si e pathemeltë.

Andaj, gjykata, nga arsyet e cekura më lart, bazuar në nenin 69, 71 dhe 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

CP.nr.154A/14, me datë 20.03.2024

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.